



Data: 25.02.2019

Ref.: 305/19 0

Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25. 05. 2016), Nenit 7 dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Kolegjit UBT si më poshtë:
 - 1.1 Arkitekturë dhe Planifik Hapsinor, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren);
 - 1.2 Infermieri, BSc, 180 ECTS;
 - 1.3 Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS;
 - 1.4 Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren);
 - 1.5 Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS, dhe
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (tash e tutje KShC) me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore, dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë, me datë 11.06.2018 ka njoftuar të gjitha IAL-të se nuk do të toleroi mos përmbushje të kriterëve të cilat derivojnë nga dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e arsimit të lartë, dhe se në secilin rast të konstatimit të mungesës së stafit akademik sipas dispozitave ligjore në fuqi, do të procedoi me tërheqje të akreditimit.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë apo jo të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoj në detaje të gjithë dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës të programeve nga Kolegji UBT. Pasi analizoj të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sipas pika një (1) të nenit 21, të UA për Akreditim, "AKA e rezervon të drejtën të monitorojë dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Sipas pikës dy (2), "AKA mund

Sipas Nenit 26, pika 5.3.11 e UA për Akreditim, *“Programet e studimit me mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është paraparë më këtë UA, (Infermieri BSc, Mami, BSc dhe Gjuha e Shenjave BSc), do të lejohen të hyjnë në procedurë të vlerësimit dhe akreditimit, me kusht që institucioni i arsimit të lartë do të siguron AKA-në që ka marrëveshje të bashkëpunimit me të paktën një institucion ndërkombëtar të arsimit të lartë i cili në vendin e tij të origjinës është i akredituar”*. Përveç asaj çka u tha me sipër IAL-të duhet të kenë staf permanent nga fusha e studimit, të paktën me gradën MA.

Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji UBT për programin e studimit, *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, u konstatua që vetëm Shqipe Agushi MA në Shëndetin e Komunitetit i plotëson kriteret për të qenë bartëse e këtij programi. Ndërsa, stafi tjetër i prezantuar si bartës të këtij programi: Fellenza Spahija (MA Menaxhment Sendetësor), Fatlume Arifaj (MA Menaxhment Sendetësor), Yllka Krasniqi, Miradije Kica, Agim Krasniqi (Dr. në Mjekësi), Dardan Dreshaj (Dr. në Mjekësi), Aferdita Kurti Karameta (Dr. në Mjekësi), Julinda Alidemaj (Dr. në Mjekësi), Dafina Gexhaj (Menaxhment Sendetësor) dhe Vjollca Shahini (MSc në Psikologji Këshilluese), nuk i përkasin fushës së infermierisë, dhe të njëjtit nuk mund të jenë bartëse e këtij programi. Bazuar në deklarinim të Yllka Krasniqi, konfirmohet se e njëjta ka tri marrëdhënie të rregullta të punës dhe atë me Kolegjin Universum, Kolegjin ISPE dhe me Kolegjin UBT, dhe mbi këtë bazë e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit. Edhe Miradije Kica sipas deklarinimit të saj, ka dy marrëdhënie të rregullta të punës, dhe atë në Kolegjin Universi dhe Kolegjin UBT, dhe mbi këtë bazë e njëjta nuk mund të pranohet si bartëse e këtij programi të studimit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të Nenit 26 dhe pikës dy (2) të Nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji UBT ka paraparë këta persona: Belul Beqaj dhe Artan Mustafa. Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*.

Ky program ka 120 ECTS dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA së referuar më lartë, për këtë program të studimit Kolegji UBT, duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji UBT për programin e studimit, *Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS*, u konstatua që ky program nuk ka staf të mjaftueshëm të fushës së programit të studimit, sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Belul Beqaj është PhD në Shkenca Politike, ndërsa Artan Mustafa është PhD në Filozofi. Bazuar në fushën e studimit të stafit të referuar më lartë, KSHC erdhi në përfundim që asnjëri nuk i përket fushës së programit të studimit, andaj mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Media dhe Komunikim, MA, 120 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren)*, si bartës të këtij programi Kolegji UBT ka paraparë këta persona: Lutfi Bina, Nol Dedaj dhe Ylber Limani. Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji UBT, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji UBT për programin e studimit, *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren)*, u konstatua që ky program nuk ka staf të mjaftueshëm të fushës së programit të studimit, sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Të tre bartësit e këtij programi (Lutfi Bina, Nol Dedaj dhe Ylber Limani) të studimit janë PhD në fushat e studimit në Shkenca Teknike.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit sipas pikës 5.3.4 dhe 5.3.11 të Nenit 26 dhe pikës dy (2) të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, ta tërheq akreditimin për programin e studimit *Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, BSc, 180 ECTS (dega në Prizren)*.

5. Për programin e studimit: *Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji UBT ka paraparë këta persona: Gelina Maliqi, Ilir Hajdini dhe Hazer Dana. Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*

Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji UBT, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas kontrollimit të dokumentacionit për stafin akademik të vendosur nga Kolegji UBT për programin e studimit, *Sistemet e Informacionit, BA, 180 ECTS*, u konstatua që ky program nuk ka staf të mjaftueshëm të fushës së programit të studimit, sipas nenit 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Nga tre bartësit e programit të studimit, vetëm Gelina Maliqi është PhD në Sistemet e Informacionit, i cili i plotëson kushtet ligjore për të qenë bartës i programit të studimit. Ndërsa Ilir Hajdini, PhD në